



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.48/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevcu anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se posterit në hapësirat publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kështu që Koalicioni PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë më vlerë prej 2,000.00 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017, ka vërejtur se në rrugën Idriz Gjilani në Prishtinë, në hyrje të tunelit në lagjen Dardania, monitoruesi ynë ka hasur në postierin e kandidatit për deputet nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, për një tubim elektorale të vendosur në hapësirat publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.03/L-073, duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD dhe 1 (një) fotografinë të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë, te Koalicioni PDK-AAK-NISMA, të datës 06.06.2017 thekson se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistët të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën Zgjedhore nr. 11/2013 neni 4.1,(b). Edhe përkundër kësaj koalicioni ka marrë masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar sipas Anr. 48/2017. Koalicioni ka evituar shkeljen dhe të gjitha këto veprime të ndërmarra provohen me dëshmi (fotot) që janë pjesë e përgjegjës. Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se postieri i kandidatit për deputet në fushatën zgjedhore i Koalicionit PDK-AAK-NISMA, është vendosur në hapësirat publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton "Veprimet e ndaluara nga

ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofruar shihet qartë se nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33,pika b) të LPZ-së pasi që postieri i kandidati për deputet nga Koalicioni janë vendosur ne objektin e hapësirave publike të qytetit .të cilën shkeljen e ka pranuar edhe me koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se postieri i kandidatit për deputet është vendosur në hapësira publik.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se koalicioni në fjalë, ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr postierin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartasin e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin të këtij vendimi.

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 48/2017 më datën 06.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.

